



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 468/2 Prot.

Tiranë, më 23.10.2018

V E N D I M

Nr.85, datë 23.10.2018

“Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 129 datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare për shkak dorëheqje dhe kërkesës për lëvizje në detyrë të nëpunësit ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të mbledhur në kuadër të verifikimit të informacionit të marrë nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave -Qendër,

VËREJ SE:

Nëpunësi ***** , nëpërmjet kërkesës së rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 468, datë 24.05.2018, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, për verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 129 datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare pas kërkesës për dorëheqje prej tij. Në të njëjtën kohë ai ka parashtruar edhe pretendimin e tij për të kaluar nga pozicioni i mëparshëm si drejtues i ISHMPU-Dega Kukës në pozicionin e premtuar prej Kryeinspektorit, të Përgjegjës të Sektorit të Mjedisit në ISHMPU-Kukës.

Nga zhvillimi i procesit të hetimit administrativ,rezulton se, punonjësi ***** , ka filluar punë në pozicionin Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe

Ujërave, Dega Rajonale (*Qarku*) Kukës, me aktin e emërimit nr. 1206, dt. 21.02.2014 të Ministrisë të Mjedisit (*siç parashikonte legjislacioni i kohës*).

Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, ai ka fituar statusin e nëpunësit civil në këtë pozicion, status të cilin e ka mbajtur deri ditë daljes së aktit nr. 129, datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, përlirimin nga shërbimi civil, për shkak të dorëheqjes, së paraqitur më datë 11.04.2018, pranë njësisë së burimeve njerëzore.

Kërkesa është miratuar menjëherë nga drejtuesi i institucionit, duke u pasuar me nxjerrjen e aktit nr. 129, datë 11.04.2018, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve financiare, i cili i është komunikuar dhe Njësisë Përgjegjëse (DAP), me shkresën nr. 1553 datë 12.04.2018.

Në ankesën drejtuar Komisionerit, nëpunësi ***** ngre pretendimin se kërkesën për dorëheqje e ka bërë në kushtet e presionit të vazhdueshëm prej Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër dhe premtimit të këtij të fundit, se do ta emëronte në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Mjedisit në ISHMPU-Kukës, i cili ishte vend i lirë. Në pikën 2, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, parashikohet rregull që dorëheqja është një akt që nuk është nevoja të motivohet në lidhje me arsyet e këtij veprimi dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. Përgjithësisht, në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, dorëheqja mund të prodhojë efektet edhe para afatit 30 ditor nga njoftimi (*pika 3, e nenit 64, të ligjit*).

Konstatohet se, në rastin konkret nuk ka një kërkesë të motivuar nga ana e nëpunësit dhe nuk ka ndonjë arsye të justifikuar nga punëdhënësi, për fillimin e menjëhershëm të efekteve të dorëheqjes dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare. Miratimi i dorëheqjes, ndonëse në përmbajtje është i drejtë, për shkak se lidhet me vullnetin për dorëheqje, shprehur prej vetë nëpunësit, përmban një moment të zbatimit të gabuar të ligjit material në lidhje me momentin e fillimit të efekteve të tij, gjë e cila në bazë të nenit 109, pika "d", të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave administrative i RSH*", passjell paligjshmërinë e aktit nr. 129 datë 11.04.2018, për këtë pjesë.

Sa më sipër arrihet në përfundimin se, akti për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësin ***** është nxjerrë në shkelje të dispozitës së nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Duke vlerësuar veprimet e mësipërme, të kryera nga Kryeinspektori i ISHMPU-Qendër, në cilësinë e eprorit direkt, por edhe veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, akti duhet të

korrigjohet në paragrafin e fundit të tij, ku shënohet “Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë” duke u bërë shënimi i saktë, “Ky urdhër hyn në fuqi pas 30 ditësh”. Me këtë rast, duhet të kryhet edhe shpërblimi i nevojshëm financiar, për kohën prej 30 ditësh, të fillimit të efekteve të aktit të dorëheqjes.

Pretendimi tjetër i nëpunësit *****, se jep dorëheqjen nga detyra Kryeinspektor i ISHPMU – Dega Rajonale Kukës, me kusht për tu sistemuar në pozicionin vakant “Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit” në degën rajonale Kukës, nuk mund të merret parasysh. Nëpunësi civil është i lirë të disponojë marrëdhënien e tij në shërbimin civil me anë të dorëheqjes, por plotësimi i pozicioneve të lira mund të kryhet vetëm nëpërmjet respektimit të procedurës së konkurrimit, për pranim në shërbimin civil, lëvizje paralele ose ngritje në detyrë.

Për më tepër, në pikën 4, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është parashikuar shprehimisht kjo e drejtë, në të cilën thuhet: “Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji deri në dy vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”

Në referim të kësaj dispozite, nëpunësit *****, i lind e drejta që të konkurrojnë si nëpunës civil, sipas neneve 25 dhe 26, të këtij ligji, në momentin që pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit” në ISHPMU - Dega Rajonale Kukës, do të shpallet i lirë, për tu plotësuar me anë të konkurrimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit të ISHMPU-Qendër, të drejtojë procesin për ndryshimin e paragrafit të fundit të aktit administrativ nr. 129 datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit “Urdhër, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, për nëpunësin *****, duke shënuar se: Efektet financiare të këtij akti, fillojnë 30 ditë pas njoftimit të dorëheqjes.
2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative dhe financiare, lihet afat 15 ditë, nga marrja e vendimit.

3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave-Qendër, Departamenti Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha